



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 06.10.2025
Numër Protokolli: 6718/2025

A.nr.1154/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtare, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.1154/2025, të datës 18.06.2025, të parashtruar nga ankuesja V.R, kundër organit të punësimit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, s i dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1154/2025, e datës 18.06.2025, e parashtruar nga ankuesja V.R.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi i datës 11.06.2025 i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financa, Punës dhe Transfereve. lidhur me kandidatin fitues në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00017457, për pozitën për pozitën “*Zyrtar i Lartë Ekzekutiv*” në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave ,Punës dhe Transfereve.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, V.R.(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), me datë 18.06.2025, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.1154/2025, kundër procedurës së rekrutimit me shifër RN00017457 për pozitën Zyrtar i Lartë Ekzekutiv, klasa e pozitës Profesional 1, numri i kërkuar 1, të shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 10.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (tutje MFPT), ndërsa kjo e fundit, me datë 17.07.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i*

Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 4124/2025 e parashtruar nga ankuesja më datën 18.06.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Konkurs i datës 25.03.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë 10.07.2025; Përgjigje në ankesë e datës 17.07.2025; Njoftimin e datës 11.06.2025 për kandidatin fitues; Formulari i renditjes përfundimtare i datës 11.06.2025; Vendimin e datës 02.05.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm të MFPT-së me akt emërimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimit; Aplikacionin e kandidates së suksesshme e datës 23.04.2025; Diplomë e datës 21.09.2020 Nr.7072; Vërtetimin e datës 24.04.2025 i Njesisë së Burime Njerëzore e Kuvendit të Kosovës; Akt Emërimit e datës 01.08.2022; Aplikacionin e datës 18.04.2025 të kandidates V.R me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e datës 23.04.,2025 për Kandidaten E.K; Testin me shkrim të kandidates së suksesshme.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e **pabazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, më datë 25.03.2025 ka shpallur konkursin me numër reference RN00017457, për Grupi i Administrimit të Përgjithshëm Arsimit i Lartë, pozita “Zyrtar i Lartë Ekzekutiv-Profesional I” në kuadër të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, ku afati për aplikim ka qenë nga data 26.03.2025 deri më 24.04.2025, ndërsa sipas shkresave të lëndës, konstatohet fakti se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak.

Tutje, ankuesja i është nënshtruar testimit me shkrim dhe intervistës me gojë dhe e njëjta ka arritur të grumbulloj gjithsejtë 73 pikë, sipas Njoftimit të datës 11.06.2025 për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve, pas kryerjes së intervistimit me gojë, rezulton se e njëjta është radhitur e dyta, ndërsa kandidati që ka marrë më së shumti pikë, është E.K me gjithsejtë 96.2 pikë, prej të cilave 67.6 pikë nga testi me shkrim dhe 28.6 nga intervista me gojë, e cili rezulton të jetë edhe kandidatja e suksesshme në procedurën përkatëse të rekrutimit.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill, kundër procedurës së rekrutimit me shifër RN00017457 për pozitën Zyrtar i Lartë Ekzekutiv, të shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, pretendon se e njëjta ka punuar dhe ka qenë më e suksesshme se kandidatja fituese dhe kërkon sqarim të detajuar mbi kriteret që janë përdorur në përzgjedhjen përfundimtare dhe po ashtu përvoja ime profesionale dhe kualifikimet e mia arsimore përmbushin plotësisht kriterin e konkursit.

Kolegji i Këshilli, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen Konkursit publik me numër reference RN00017457 për Grupin e administrimit të përgjithshëm-Arsimit i Lartë, respektivisht për pozitën e punës “Zyrtar i Lartë Ekzekutiv” në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave ,Punës dhe Transfereve, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar: Diplomë e Arsimit të lartë e nivelit të parë(Baçelor), Kërkesat specifike;** nuk ka, **Përvoja e punës e kërkuar:** së paku dy(2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës dhe si rrjedhojë Kolegji vlerësoj se kriteret e përgjithshme për pozitën përkatëse të punës kane qenë në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Fillimisht Kolegji i Këshillit, nga analizimi i testit me shkrim të ankueses konstatoi se e njëjta nga testi me shkrim kishte arritur të grumbullonte gjithsejtë 52.6 pikë dhe intervistën me gojë kishte marrë 20.4 dhe ka grumbulluar gjithsejtë 73 pikë ndërsa kandidatja e suksesshëm nga testi me shkrim kishte arritur të grumbullonte gjithsejtë 67.6 pikë (*prej të cilave 50 pike nga pyetjet me përgjigje opsionale, kurse 17.6 pikë nga eseja*), dhe 28.6 pikë në intervistën me gojë, dhe me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses lidhur me vlerësimin në secilën fazë gjegjësisht testit me shkrim, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat e nenit 4 të Rregullores (QRK) NR. 05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil ku përcaktohet se “*Obligohet ministria përgjegjëse për administratën publike që brenda një (1) viti nga miratimi i kësaj Rregulloreje, të hartojë një bazë të dhënash me pyetje për testimin me shkrim dhe/apo intervistën me gojë. Deri në krijimin e kësaj baze të dhënash, Komisioni i Pranimit në përbërje të plotë është i obliguar që jo më herët se njëzet e katër (24) orë para mbajtjes së testit, të hartojë pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara 3/4 në shpalljen për rekrutim. Pyetjet vendosen në sistemin elektronik nga Komisioni, i cili administron procesin e testimit*”, si dhe dispozitat e nenit 9 paragrafi 6 dhe 8 të Rregullores (QRK) 16/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: “*6. Testi me shkrim përmban gjithsejtë njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimit, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimit*”, dhe konstatoi se sistemi që funksion në kuadër të SIMBNJ-së, është i programuar në atë mënyrë, ashtu që përgjigjen e saktë e ka të identifikueshme dhe vlen njëtrajtshëm për të gjithë kandidatët që i nënshtrohen testimit me shkrim, sikurse edhe në rrethanat e rastit konkret, ku ankuesja ka dhënë 22 përgjigje të sakta në pyetjet opsionale dhe ka grumbulluar 44 pike ndërsa Komisioni i Pranimit e vlerëson vetëm esenë, nga rrjedh se sipas testit me shkrim të datës 04.06.2025 me kod aplikimi CN6910-ankuesja për vlerësimin e eses nga anëtarët e komisionit është vlerësuar me gjithsejtë (8.6) pikë, sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 9 paragrafi 9 të së njëjtës rregullore: “*9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim*”, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se pretendimet e ankueses nuk janë të bazuara, ngase Komisioni i Pranimit asnjërin nga kandidatët nuk e ka vlerësuar me 20 pikë, aq sa është edhe maksimumi i vlerësimit të eses, respektivisht ankuesen e ka vlerësuar me gjithsejtë 8.6 pikë, kurse e ka vlerësuar në ese me 17.6 pikë, ndërsa në interviste me gojë ankuesen Komisioni e është vlerësuar me 20.4 pike, kurse kandidatin e suksesshëm E.K e ka vlerësuar me 28.6 pike ashtu që Kolegji i Këshillit nuk gjeti se në këtë fazë ka pasur shkelje sikurse ankuesja pretendon.

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të provave të lëndës ka shqyrtuar edhe aplikacionin e datës 23.04.2025 të kandidatës fituese E.K e cila posedon :Diplomën me numër 7072 të datës 21.09.2020 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” me te cilën dëshmohet se ka përfunduar Fakultetin Filozofik në dhe mori titullin Bachelor i Shkencave Politike. Diplomën Master të datës 06.09.2023 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” me te cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet Master në Fakultetin Filozofik në dhe mori titullin Master i Shkencave Politike, ndërsa sa i përket përvojës së punës e njëjta posedon Vërtetimin e datës

22.04.2025 të lëshuar nga Drejtorja e Drejtorisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Kuvendin e republikës së Kosovës me të cilin vërtetohet se e njëjta ka punuar ne pozitën asistente e kryetarit te Komisionit parlamentar nga data 01.08.2022 deri me date 22 mars 2025 gjithsejtë dy vite (2) e shtatë muaj (7) e njëzetë e një ditë (21), po ashtu e njëjta ka dorëzuar edhe Akt emërimit e datës 01.08.2022 dhe Akt Emërimit e datës 11.05.2023 të cilën përvojë e mbështet edhe me pasqyrën e Trustit Pensional.

Andaj, duke marrë për bazë konstatimet e dhëna si më lartë, dhe meqenëse Kolegji i Këshillit konstatoi se pretendimet ankimore të ankueses nuk janë të bazuara dhe për rrjedhojë procedura e rekrutimit është zhvilluar në pajtueshmëri me dispozitat e aplikuara ligjore të ligjit material, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit vendosi sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, ashtu që refuzoi ankesën e ankueses, ndërsa la në fuqi Njoftimin e datës 11.06.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financa, Punës dhe Transfereve lidhur me kandidatin fitues për pozitën “Zyrtar i Lartë Ekzekutiv” në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave ,Punës dhe Transfereve, pasi që i njëjti është nxjerrë duke u bazuar në ligjin material dhe në dispozitat e përcaktuara si në nenin 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurat e Pranimit në Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër, A.nr.1154/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses V.R;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.